



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

---

Numri i lëndës: 2022:245643  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05479010

CP.nr.02/2001

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores, E.K., nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. F. H.SH., nga Prishtina, kundër debitorit, Harun Krasniqi nga Prizreni, rr”,.....” nr....., për pambarimin e dokumentit përmbartues aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.51/2000 i datës 08.11.2000, për shkak të alimentacionit, i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.02/2001, të dt.10.01.2001, jashtë seancës gjyqësore me datën 21.03.2024 mori këtë :

**A K T V E N D I M**

I.PËRFUNDOHET procedura e përmbartimit, në çështjen juridike të përmbartimit E.nr.02/2001, për përmbartimin e dokumentit të përmbartimit, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.51/2000 i datës 08.11.2000, dhe atë për shkak të pa mundësisë së përmbartimit.

II. Shpenzimet e procedurës së përmbartimit, bien në barrë të kreditores së përmbartimit.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komunale në Prizren me aktvendimin e saj E.nr.02/2001 të dt.10.01.2001, ka lejuar propozimin për përmbartim të kreditores E.K., nga Prizreni, kundër debitorit, H.K., nga Prizreni, e për pambarimin e dokumentit të përmbartimit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.51/2000 i datës 08.11.2000, përkritazi me pagesën e alimentacionit.

Kjo gjykatë duhet vepruar me tej në këtë çështje përmbartimore, me datën 13.07.2005 ka përpiluar procesverbal mbi regjistrimin dhe vlerësimin e sendeve të debitorit.

Me konkluzionin e kësaj gjykate E.nr.02/2001 të datës 25.07.2005, është njoftuar kreditori se është bërë tentim regjistrimi mirëpo pa sukses, sepse nuk janë gjetur sende të cilat mundë të jenë lëndë përbarimi.

Kështu kjo gjykatë ka caktuar dhe mbajtur disa seanca gjyqësore, dhe në seancën e datës 25.10.2018 është urdhëruar debitori H.K., që në afatin prej 7 ditëve që të zbatoj aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.02/2001 të datës 10.01.2001 për lejimin e përbarimit të dokumentit të përbarimit aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.51/2000 të datës 08.11.2000 për të paguar alimentacionin shumën prej 100 DM e tani në kundërvlerë në Euro, e në të kundërtën gjykata do të shqiptoj gjobë ndaj debitorit për mos veprim sipas kësaj urdhërese, dhe i është tërhequr vërejtja debitorit që moszbatimi i vendimit të gjykatës është vepër penale e sanksionuar me Kodin Penal të Kosovës

Kreditorja me datën 25.10.2018 në këtë gjykatë ka paraqitur propozim për zgjerimin e përbarimit, ndaj debitorit, lidhur me mjetet dhe objektin e përbarimit, ku kjo gjykatë me aktvendimin E.nr.2/2001 të datës 01.11.2018, këtë propozim e ka lejuar, dhe ndaj lejimit të propozimit për zgjerimin e përbarimit nuk është paraqitur prapësim nga ana e debitorit, dhe ky aktvendimin është bërë i përbarueshëm dhe i formës së prerë në procedurën e përbarimit.

Gjykata me aktvendimi E.nr.02/2001 të datës 11.11.2019, debitorit të përbarimit i ka shqiptuar gjobën në shumën prej 300.00 euro, për shkak të mosrespektimit të aktvendimit të kësaj gjykate, si dhe urdhëresës së kësaj gjykate për përmbushjen e detyrimit në të holla që rrjedh nga dokumenti i përbarimit.

Kjo gjykatë me aktvendimin E.nr.02/2001 të datës 12.11.2019, e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditëve, të i tregoj të gjitha të dhënat për pronën e luajtshme dhe të paluajtshme e në veçanti në lidhje me llojin dhe nivelin e të hyrave dhe depozitave në të holla si dhe vendin ku ndodhet pasuria e këtillë.

Gjykata me datën 14.11.2019 ju ka Drejtuar Prokurorisë Themelore në Prizren me Shënim Zyrtar për debitorin, pasi që i njëjti nuk i ka respektuar vendimet e gjykatës, lidhur me detyrimin e tij që ka ndaj kreditorit.

Gjykata duke vepruar me tej në funksion të zbatimit të vendimit të lartcekur, ka caktuar disa seanca, dhe në seancën e datës 19.02.2023, i autorizuar i kreditores, i ka propozuar gjykatës që të caktohet eksperti financiar lidhur me ekspertizën financiare për llogaritjen e shumës që debitori ka për detyrim ndaj kreditores nga momenti i lindjes së detyrimit sipas aktgjykimit C.nr.51/2000 i datës 08.11.2000, e deri në momentin kur kreditorja ka mbushur moshën madhore përkatësisht me datën 14.09.2013, dhe kjo gjykatë e ka aprovuar propozimin e kreditores për caktimin e ekspertit për nxjerrjen e ekspertizës.

Gjykata me aktvendimin E.nr.02/2001 të datës 19.01.2024, e ka caktuar ekspertin financiare A.K., nga Prizreni, për kryerjen e ekspertizës me detyrat e dhëna si në këtë aktvendim.

Ekspertja financiare A.K., nga Prizreni, kësaj gjykate me datën 25.01.2024, ja ka dorëzuar ekspertizën e punuar, ku në bazë të mendimit profesional të ekspertes shuma e detyrimit të alimentacionit të papaguar nga vitit 2000 e deri në vitin 2013 e shprehur në euro, është 7,750.00 euro.

Kjo gjykatë përmes sistemit elektronik, ka tentuar që të siguroj ndonjë pasuri që mund ti ketë debitori për tu sekuestruar në llogarinë e tij dhe atë përmes sistemit RLLPB-BQK, por nga këto dhëna kanë rezultuar se debitori nuk posedon ndonjë pasuri për tu sekuestruar, pasi që llogarit e debitorit sipas këtij sistemi janë të bllokuara.

Gjykata me shkresën e datës 29.02.2024 ju ka drejtuar Komunës së Prizrenit-Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, për sigurimin e të dhënave për patundshmëritë që mundë ti ketë në emrin e tij debitori H.K., në mënyrë që kjo gjykatë të veproj në këtë çështje përmbarimore.

Komuna e Prizrenit-Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër me datën 14.03.2024, e ka njoftuar këtë gjykatë se nuk ekziston paluajtshmëri në emër të debitorit H.K., nga Prizreni.

Kështu kjo Gjykatë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se, dokumenti i përmbarimit, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.51/2000 i datës 08.11.2000, është bërë i pamundshëm dhe nuk mundet të zbatohet, dhe atë për këto arsye:

Për rastet kur përmbarimi, është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqet të tjera nuk mundet të zbatohet, në një çështje juridike të përmbarimit, bëhet fjalë në nenin 66 par.3 të LPP-së, e në të cilin, thuhet: *''Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, ...''*. Duke qenë se në propozimin për përmbarim, pala kreditore, ka paraqitur dokumentin përmbarues, aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr.51/2000 i datës 08.11.2000, për tu përmbaruar, gjykata për kundër disa tentimeve që të zbatohet përmbarimi i vendimit, erdhi në përfundim se, përmbarimi është bërë i pamundshëm dhe nuk mundet të zbatohet, kështu që kjo gjykatë vlerëson se, në këtë raste duhet t'a përfundojë procedurën e përmbarimit, për shkak se në këtë çështje juridike përmbarimore, përmbarimi i vendimit është i pamundshëm dhe nuk mundet të zbatohet në këtë çështje juridike të përmbarimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar në kuptim të nenit 13 par.1 të LPP-së.

Prandaj, nga te thënat si me lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e sipas nenit 3, 13 dhe nenit 66 par. 3 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm  
CP.nr.02/2001  
Datë 21.03.2024

Numri i lëndës: 2022:245643  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05479010

Gjyqtari,  
Sami Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, e nëpërmjet kësaj Gjykate.